



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 4 dhe 11 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme nr. 03/L-139 dhe me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr. 03/L-205, nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 dhe neneve 14 dhe 16 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në zbatim të Vendimit nr. 01-016/01-0093084/18 për shpallje të interesit publik, i miratuar në Kuvendin e Komunës më 30.11.2018, merr:

### **V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

#### **Neni 1**

Miratohet shpronësimi i pjesëve të parcelave dhe disa objekteve në Zonën Kadastrale Podujevë, sipas Listës me përshkrim të paluajtshmërive në shtojcë të këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik për realizimin e projektit *"Asfaltimi i rrugës te Xhamia në Podujevë me infrastrukturë përcjellëse, ndriçim publik, kanalizim fekal, kanalizim atmosferik, rrjet të ndriçimit, ujësjellësit, sinjalizim horizontal dhe vertikal, ura mbi lumin Ilap( afër kompleksit banesor Malësia).*

#### **Neni 2**

Obligohet Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit që brenda pesë (5) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi të njëjtin t'ua dërgojë pronarëve ose zotëruesve të interesit në pjesë të pronave të paluajtshme të cilat preken me realizimin e projektit, dhe brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit, i njëjti shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

#### **Neni 3**

Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave që brenda afatit prej dy (2) vite, të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pjesëve të parcelave dhe disa objekteve të shpronësuara, të përcaktuar në Aktin e vlerësimit nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme n 'kuadër të Ministrisë së Financave (shkresa nr.prot.09/271-1 datë 01.07.2019), i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

#### Neni 4

Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi, secili pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose në të drejtat pronësore që janë objekt i këtij vendimi përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili pretendon se ka një interes të drejtpërdrejt në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, kanë të drejtë ankese në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Podujevë, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit, në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin nr.03/L-205.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

#### Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij, vendim i cili paraqet bazë juridike për regjistrime në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale.

#### Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh.

*Vendimi u dërgohet:*

- Të gjitha Drejtorive të Komunës
- Pronarëve ose zotëruesve të interesit
- Arkivit

**Nr. 02-464/01-0068143/19**  
**Podujevë, 22 gusht 2019**

